



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 884 Prot.

Tiranë, më datë 25.06.2021

VENDIM
Nr. 311, datë 25.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstrukcion Kullë 3 Kate + Nënçati + Podrum”, brenda kufirit të Qendrës Historike të fshatit Theth, me aplikues dhe projektues restaurator Zef Çuni dhe zhvillues Mark Rupa;
2. Subjekti duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 733, datë 08.12.2017 “Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Theth, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth të saj dhe miratimin e Rregullores për Administrimin e saj”, Neni 10, Pika 2:
 - Zbatimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori në restaurim;
 - Mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori caktohet nga IKTK pas njoftimit të subjektit për fillimin e punimeve;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

